



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 25 të Rregullores (QRK) nr. 13/2017, për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2020, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHE SUAR NË KOMUNËN E PRISHTINËS**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për Planin komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës, 2020-2022.

**Neni 2**

Plani i veprimit, i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, është bazuar në Strategjinë nacionale dhe Planin e veprimit për zbatimin e strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimet për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

**Neni 3**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës, 2020-2022.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe organet kompetente të Administratës komunale.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-561/02-58555/20, më 11.03.2020

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

